



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për komunitete

01Nr. 06-14540 2024

Klinë, dt. 05. 03. 2024

29/03/2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete të mbajtur me datë 05. 03. 2024 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesja e Komitetit znj. Besiana Gashi e cila përshëndeti anëtarët e komitetit, drejtorin e shëndetësisë z. Agron Bacaj dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesja prezantoi Rendin e Ditës dhe kërkoj nëse dikush nga anëtarët dëshiron të thotë ndonjë gjë.

Me vota unanime u MIRATUA Rendi i Ditës.

Pika 1 e endit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Të pranishëm janë 6 anëtarë të komitetit ndërsa z. Nexhmedin Gashi sipas kryesueses do të bashkëngjitet në vazhdim të mbledhjes.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Me 6 vota për u MIRATUA

Pika 3 e Rendit të Ditës: Informim nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

z. Agron Bacaj, drejtor i Sh.: Përshëndetje të gjithëve. Nga hera e fundit të raportimit tim këtu në këtë komitet trendi i punëve ka qenë i njëjtë me kapacitetet dhe mundësitë që ka ofruar QKMF dhe ndihmën e vogël të ministrisë së shëndetësisë. Po them ndihmën e vogël të ministrisë sepse njësia e shëndetësisë përveç fatit që na i dikton llojet e shërbimeve që ne i ofrojmë ajo ka për obligim edhe furnizimin me barna esenciale por që kjo listë e furnizimit ka qenë e vogël. I njëjti trend po vazhdon edhe me tutje dhe gjitha nevojat dhe kërkesat janë mbuluar nga drejtoria e jonë përmes kontratave që ka me operator privat. Kontakti im i fundit që kam pasur me zyrtar të ministrisë na kanë thënë se gjatë muajit mars do të filloj furnizimi. Sfidë gjithashtu është edhe largimi i mjekëve nga QKMF dhe nga Kosova dhe shihet është në rritje. Aktualisht ne kemi 3 mjek që janë në pushim pa pagesë dhe gjasat janë të vogla që ata të kthehen. Shërbimet që ofrohen në QKMF sidomos këto që kanë kosto buxhetore dhe ka numër të madh të pacientëve bëhen në QKMF. Barnatorja në QKMF është e

furnizuar mirë, Rëntgeni po ashtu, Mjekët që janë aktiv janë në krye të punës. Kryesisht mungesë e stafit ndjehet tek mjekët. Nëse dëshiron dikush diçka që i intereson unë i kam edhe statistikat që mund të ju përcjell.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve si dhe drejtorin Bacaj. E dijë që ka pasur problem me herët me funksionimin e QMF dhe AMF-ve. Ku është problemi?

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Gjendja paraqitet e njëjtë në funksionimin e QMF dhe AMF pasi që mungojnë mjekët dhe aty shërbejnë teknikët dhe infermierët vetëm. Kemi provuar që të dërgojmë mjekët në orar të caktuar aty por është vërejt që numri i pacientëve është shuam i vogël. Ndoshët sepse shumica e qytetarëve ato shërbime duan që të i bëjnë në QKMF. Ajo që është me rëndësi të theksohet tani është programi i vaksinimit që ka filluar tek vajzat e moshës 12 vjeçare. Ka pasur një hezitim nga ana e prindërve dhe ne kemi pasur një fushatë vëtdijsuese pasi që vaksina e re e futur tani në protokoll është shumë e rëndësishme sepse ka të bëjë me kancerin e qafës së mitrës dhe ftoj prindërit që të i përgjigjen ftesës për vaksinim të vajzave të kësaj moshe. Ne do të bëjmë përpjekje që të i forcojmë shërbimet edhe në QKMF dhe në AMF por është shuam sfiduese.

z. Vehbi Alaj: Përshëndetje. Po flas në emër të komuniteteve. Shërbimet mjekësore janë shumë korakte dhe nuk ka asnje dallim. Shërbimi me furnizim me barna nga barnatorja e QKMF është e mangët dhe po detyrohem që të bëjmë blerje në barnatore private.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: E kuptoj dhe e sqarova më herët që lista esenciale e barnave është e mangët por pavarësisht kësaj mjekët ashtu siç e parashohin se duhet marr terapia ne nuk mund të ndikojmë.

Znj. Besiana Gashi, kryesuese: z. Drejtor në lidhje me vaksinimin e vajzave që sapo e përmendet, e kam parë mënyrën se si organizohet vaksinimi në qytet, në shkollat e qytetit por dua ta dijë se si është organizuar në shkollat në vendet rurale, a ka interesim për vaksinim dhe si është gjendja.

z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë: Është bërë orari i vaksinimit nëpër tërë territorin e komunë së Klinës. Ne i kemi njoftuar edhe drejtorin e arsimit edhe drejtorët e shkollave. Orari i vizitave dhe vaksinimit nëpër shkolla është i ndarë.

Kryesuesja konstatoi se z. Nexhmedin Gashi ju bashkua mbledhjes. Kryesuesja gjithashtu falënderoj drejtorin Bacaj për kontributin dhe pjesëmarrjen e tij.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Informim nga zyra për informim dhe kthim.

Përfaqësuesi i zyrës për komunitete dhe kthim fillimisht ishte i pranishëm por si duket kishte një telefonatë dhe doli nga mbledhja dhe nuk u kthye sërisht që të raportoj, informoj sipas rendit të ditës.

Në lidhje me mungesën e përfaqësuesit të zyrës për komunitete dhe kthim foli z. Nexhmedin Gashi, znj. Besiana Gashi dhe Arben Limanaj të cilët konstatuan se sjellja e përfaqësuesit nuk është serioze, të ngritët ky shqetësim dhe të evidentohet në procesverbal.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Të ndryshme

z. Djuro Krasic: Përshtendetje të gjithëve. Të ju informoj se në Gremnik dhe Dollc ka filluar esproporimi i tokave dhe kam shumë vërejtje për nivelin qendror. Albin Kurti na ka dërguar vetëm në gjuhën shqipe dokumentet. Sipas ligjit është dashur edhe në gjuhën serbe që ne të mos humbim kohë me përkthim. 5 ari mi akne marr mua ku shumica kanë qenë me fidanë dhe pemë dhe nuk janë regjistruar fare. Rruga që do të rregullohet blokon edhe 5 familje të tjera të cilat nuk do të mund të dalin as në oborret e tyre. Ara në anën tjetër është paguar 6000 euro për një ari, ndërsa mua që toka është shuam më pjellore na janë ofruar 1500 euro për ari. Nuk dimë se çfarë të bëjmë. Qeveria nuk po punon qysh do të duhej.

Në vazhdim me kërkesë të z. Arben Limanaj, kryesuesja e komitetit informoj anëtarët e komitetit për fjalën e saj thënë në kuvendin e komunës dhe vendimin e kuvendit të komunës për pagesën e të gjitha komiteteve të formuara nga kuvendi por sqaroj gjithashtu se ai vendim duhet të kaloj ligjshmérinë, verifikimin në ministrinë përkatëse. Në lidhje me këtë foli edhe z. Vehbi Alaj, Arben Limanaj, Nexhemedin Gashi etj.

Mbledhja e komitetit përfundoj pas përfundimit të debatit në lidhje me mos pagesën e disa anëtarëve të këtij komiteti për punën e tyre.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuese:

Besiana Gashi

